

## INTERVISTË ME SHAHADIJE NEZIRI LOHAJN

Ferizaj | Data: 9 qershor, 2023

Kohëzgjatja: 84 minuta

Të pranishëm:

- Shahadije Neziri Lohaj (E intervistuar)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## **Pjesa e Parë**

**Anita Susuri:** Zonja Shadije, nëse mundeni me u prezentu, me na tregu diçka për prejardhjen e juj?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po. Unë jam Shahadije Neziri Lohaj, e lindur në qytetin e bukur të Shkupit ku aty ka jetu prindërit e mi. Unë kam lindur me 10 shkurt të vitit 1965. Mësimet e para kam fillu në shkollën “Dame Gruev” që ishte afër shtëpisë sime. Ne jemi vendosë, familja ime është vendosë në Shkup, ngase babai im që në moshën 15 vjeçare ka migru atje dhe ka fillu shkollimin si inxhinier i teknologjisë. Pastaj, e ka përfundu shkollimin dhe është martuar me nënën time, Sabrijen, të cilët i kam të dytë ende gjallë. Jetojnë edhe domethonë në qytetin e Ferizajit. Pasi përfundova klasën e dytë, prindërit e mi vendosën të kthehen në Ferizaj, sepse hyri babai ktu në punë. Pastaj, kemi vazhduar, domethonë jetën në Ferizaj. Ndërsa unë, vazhdova mësimet në shkollën “Jeronim De Rada” që quhet tash, atëherë është qujtë, “Pekol Tepashqeviç”.

**Anita Susuri:** A mundeni me na tregu diçka ma shumë për familjen e babës të juj? Si është bo që me u shkollu baba i juj në Shkup?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po. Gjyshi im ka qenë një njeri i urtë, ka qenë një njeri i ditur. Ai ka pasë... ka qenë hoxhë i fshatit. Domethonë është shkollu, nuk ka pasë ndonjë medrese, mirëpo në atë kohë kanë qenë shkolla që janë marrë nëpër xhamia. Dhe ai e ka pa të arsyeshme që fëmijët e tij duhet të arsimohen, sepse oda e tij ka qenë odë ku kanë qëndru njerëz të ngritur. Sidomos ata që vinin dhe kishin hapur në atë kohë shkollat e para shqipe, nëse... domethonë, ishin vite të tilla. Pastaj, kanë qëndru patriotët e ndryshëm, siç ka qenë Hasan Remniku. Ka qenë mësuesi Mustafë, i cili kishte, vepronte në fshatin Remnik. Si dashamirës i arsimit, gjyshi im u pajtu që babai im të shkonte në Maqedoni, domethonë në Shkup dhe të shkollohej. Gjyshi ka qenë një njeri që ka pajtu gjaqe dhe ngatërresa të ndryshme. Ka qenë shumë dashamirës i arsimit. Gratë, vajzat e tona janë shkollu në atë kohë pothuajse të parat në fshat edhe në rrethinë.

**Anita Susuri:** A ka qenë familje e madhe?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po, ka qenë familje e madhe, pothuajse 50 vet sa e di. Oda e Ahmet Remnikut ka qenë, pothuajse si kolegji i ditëve të sotme. Kështu thuhet nga gazetarët. Sidomos e ka pasë ni, e ka

nji, një libër apo, ky Tahir Berisha që ka shkru për gjyshin tim dhe e tregon gjithë historinë dhe biografinë e tij.

**Anita Susuri:** E ju domethonë, familja e babës ka qenë prej Ferizajit?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Familja e babait tim ka qenë nga fshati Remnik...

**Anita Susuri:** A Remnik.

**Shahadije Neziri Lohaj:** Nga fshati Remnik, Komuna e Vitisë. Pastaj, babai ka shku u shkollua në Maqedoni në Shkup dhe nga Shkupi kemi ardhë në Ferizaj. Ndërsa familja e nënës sime është nga fshati Koshare, është afër Ferizajit. Aty nëna ime rrjedh nga një familje patriotike që ndoshta, që e dijme në fillimet që nga viti, koha e Sefë Kosharës. Sepse ka qenë stërgjyshi i nënës sime Sefë Kosharja që është hero që e kanë varë turqit, nëse ju kujtohet, në lis. Ka qëndru trupi i tij tri ditë dhe pastaj e kanë marrë e kanë varrosë të tjerët, domethonë nga Shtimja sa e di, disa nipa të tij.

Ne jemi rritë me frymën patriotike, sepse nëna, gjyshja që e kemi pasë vazhdimisht na ka tregu për historinë e Sefë Kosharës. Emri i tij është trashëguar brez pas brezi në familjen e nënës sime. Deri te Sefa i ri që e kemi tash i ka nja 27-28 vjet kështu. Sefa tjetër ka qenë edhe ai një person i cili ka, kur ka shku në ushtri, se i kanë marrë përpara ushtarë kanë qëndru nga dy-tri vite. Asnjherë nuk osht' kthy kufoma e tij. Ai është vra diku dhe asnjëherë, domethonë nuk osht' kthy. Vetëm ju ka ardhë ni lajmërim që ka vdekur dhe kaq.

Dajën tjetër, i cili më ka vdekë në ni ndeshje komunikacioni, e ka pasë Sefë edhe ai emrin dhe tash edhe e kemi Sefën e ri. Domethonë, familja e nënës e ka trashëgu vazhdimisht emrin e heroit të kombit Sefë Kosharja. Nëna ime ka qenë e pamundur dhe gjyshja mos me na brumosë neve me, domethonë me ndjenjat atdhetare, patriotike, që bisedat kyçe kanë qenë në familjen tonë këto biseda. Ashtu edhe te gjyshi, domethonë nga ana e babait. Dhe ne aty u frymëzum, unë dhe vëllai, të cilët jemi dënuar të dytë pastaj, sepse kemi qenë të organizuar dhe në vitin 1983 u arrestuam.

**Anita Susuri:** Deshta me ju pytë për Sefë Kosharin, atë të parin se i përmendët disa. A ka qenë në Lëvizjen Kaçake që ka qenë në atë kohë, a çfarë lëvizje ka qenë?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Sefë Kosharja ka qenë, ka qenë bashkëluftëtar i Mic Sokolit. Ai nuk ka qenë në Lëvizje Kaçake. Ai ka qenë domethonë i lidhur me Lidhjen e Prizrenit, i cili thuhet që dyndhetë vite ka qenë ushtar në kohën e turkut. Sepse ju e dini shumë mirë që i kanë marrë turqit të ritë tanë dhe i kanë çu në luftëra. Ai në Betejën e Slivovës ka luftu bashkë me Mic Sokolin. Pastaj, turqit i kanë ofru Sefë Kosharës, sepse ky ka qenë një nga luftëtarët më të mirë në atë kohë kur i ka marrë Perandoria Turke [Osmane] që i ka çu nëpër vende të ndryshme nëpër botë. Se e dini ju që ata e kanë pasë sundu gati gjysmën e Ballkanit e ni pjesë të Europës.

Ata i kanë ofru Sefë Kosharës që të kthehet dhe të bëhet me turqit, mirëpo ai nuk ka pranë. Pastaj, turqit e kanë prurë ushtrinë në atë kohë dhe e kanë rrethuar fshatin Koshare. Kanë, e kanë zënë të gjallë Sefë Kosharën, sepse jo që ai nuk ia kishte kthyer armikut, mirëpo fillun ta digjnin fshatin. Ndoshta e dini edhe kangën që thotë, “Dervish Pasha me shallvare i kthen topat në Koshare, ja ktu Sefën unë e du ja Kosharën ka me shkrumë”. I ka ofru që ai të bëhet me ta, domethonë dhe të t’i japin të drejta të ndryshme, t’i japin vende kushedi, mirëpo ai nuk ka pranë. Kështu që e marrin dhe me një, është një kodër aty në Koshare, e varin tri ditë. Nuk e kanë lanë popullatën me... ia djegin shtëpinë. Mirëpo e ka pasë vetëm gjyshin, domethonë babën e gjyshit tim e ka pasë...

**Anita Susuri:** Veç ni djalë.

**Shahadije Neziri Lohaj:** Veç ni djalë. Ai ka qenë diku gjashtë muaj, sipas të dhënave që m’i jep, gjyshja që m’i ka dhanë edhe gjyshi. Gjashtë muajsh dhe nëna e vet e merr, s’e di ju të rehat a e dini çka osht’ duja e tallës? Talla osht’ e misrit, ato pjesë tringuj misrit të teruna. Dhe e merr e shtin foshnjën aty, a shtëpinë ia ndezin, e merr edhe fillon me ecë. Ata i kanë thanë, “Ti çka po e merr këtë kur ty t’u digj krejt shtëpija?” Ajo e kishte shti foshnjën aty dhe ka ikë nga ai vend. Pastaj, e ka vazhdu jetën, ka lind gjyshi im, gjyshi të tjetër dhe kështu deri në ditët e sotme. Janë familje mjaft e madhe edhe familja e nënës time.

**Anita Susuri:** E qysh ka ndodhë që baba ju është taku me nanën? Apo ndoshta me msitni në atë kohë?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po, përpara në atë kohë ndoshta ju nuk e dini, mirëpo nëse bisedoni me të vjetrit zakonisht janë kërku familjet patriotike që nëse e ka ni djalë të mirë apo ni vajzë të mirë me ia dhonë atyne dhe kështu janë, janë njoftu me shkuesi. Domethonë, nëna ime dhe babai me shkuesi janë njoftu. I kanë feju, janë martu. Mirëpo, babai im ka jetu në Shkup dhe me nënën time atje e kanë vazhdu jetën. Pastaj, janë kthyer në Ferizaj, si duket ma afër nanës, familjes të nanës ktu.

**Anita Susuri:** E ju domethonë keni lindë atje...

**Shahadije Neziri Lohaj:** Në Shkup.

**Anita Susuri:** Në Shkup. Sa po i bjen që keni qenë...

**Shahadije Neziri Lohaj:** Deri në klasën e dytë, i bjen dhjetë vjet ndoshta, kështu diçka.

**Anita Susuri:** A ju kujtohet jeta në Shkup?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po, shpesh e mendoj. Jeta ka qenë, unë mendoj, shumë e bukur. Nuk e di pse e adhuroj akoma, ndoshta që është vendlindja ime. Sepse në atë kohë, domethonë unë jom e vitit 1965-tes unë kam shku parashkollor, më kujtohet tash thom, a din në atë kohë kam shku në

parashkollor. Më kujtohet mësuesja, më kujtohen gjanat. Pastaj fillova klasën e parë, klasën e dytë. E kam pasë mësuese Gjyle Saraçini është një mësuese shumë e zonja. Mësuesja e parë e imja. Është nëna e kësaj Valentina Saraçinit, një gazetare ka qenë edhe ajo. Ni grua që na ka përgatitur shumë mirë. ABC-në prej saj, programe të ndryshme që i përgatiste, kështu. Kam ni përshtypje shumë të mirë.

**Anita Susuri:** A ju kujtohet qyteti apo lagja ku keni jetu?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po, secila lagje i ka pasë shkollën afër aty. Lagjja që kam jetu ka qenë me shtëpi të vogla, afër njëra-tjetrës, shumë afër. Nganjëherë më dukej ma nxehtë, klima ka qenë ma e ngrohtë se në qytetin e Ferizajit. Shkolla ka qenë e bukur, ka pasë kushte të mira. Ata fëmijët që kemi jetu jemi kanë shumë të lumtur. Sepse, ndoshta, ky interneti edhe i ka përfshi pak fëmijtë që s'po kanë kohë me u shoqnu me njëri-tjetrin, përpos në atë mënyrën që hyjnë live si thojnë kështu (buzëqesh). Ne kemi bisedu, kemi lujtë lonja të ndryshme me fëmijët e lagjës.

**Anita Susuri:** E në familje, sa fëmi keni qenë?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Pesë fëmi, dy motra dhe dy vëllezër. Ni motër është më e madhe se unë, [ajo] është infermiere këtu në Ferizaj, një motër tjetër është, unë jam e dyta, i dyti fëmi i prindërve të mi. Motra... pastaj e kam vëllaun, Fatmirin, i cili është piktor që jeton dhe vepron në Francë. Edhe ai ka qenë i burgosur politik bashkë në grupin tim me mua. Pastaj, osht' motra, Bukuria, e cila është profesoreshë e gjuhës shqipe. Dhe vëllau Ziari ka qenë oficer edhe ai jeton dhe vepron në Francë. Kjo është familja ime.

**Anita Susuri:** Qysh ka qenë organizimi në familjen e ju? Për shembull prindërit?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po, ne kemi jetu ni familje shumë e lumtur kemi qenë. Babai punonte ktu në fabrikën e gypave. Përpara të punosh në fabrikën e gypave ka qenë si kushedi ku të punosh, se kanë qenë të ardhurat e mira. Na i ka plotësu kushtet fëmijëve vazhdimisht. Qëllimi i tij kryesor ka qenë që ne të shkollohemi. Nëna ime ka qenë amvise, shtëpiake domethonë. Ajo osht' marrë me neve, na ka përgatitë të gjitha. Edhe pse ka qenë amvise, ajo vazhdimisht neve na ka nxit kah libri, kah shkolla. Asniherë nuk na like diçka tjetër, vetëm na thoshte, "Shkollohuni se ne s'kemi mujtë, po bile ju shkollohuni". Na ka kriju kushtet në atë formë që neve nuk na ka munguar asgjë. Kemi qenë fëmi të lumtur, kemi qenë fëmi të, me njëri-tjetrin shumë të dashur.

**Anita Susuri:** Domethonë, jom t'u pytë se në vitin që keni lindë ju, që jeni lindë në '65-ten ka qenë edhe si fundi i periudhës së Rankoviqit. A keni pasë kontakt? Për shembull, a ju kujtohet ndonjë rrëfim ose me familjen në Kosovë?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Thashë që familja e nënës sime ka qenë familje e persekutuar. Gjyshi im, Selmani, ka qenë njeri nga ata që është persekutu nga koha e Rankoviqit. Ata i dinin familjet se cilat

ishin patriotike atdhetare dhe vazhdimisht shkonin ju bonin presion. Kështu gjyshit i kërkonin armë, të dorëzonte armën dhe gjyshi nuk kishte sepse nuk kishte armë njeriu. Nuk ka pasë armë dhe nuk e ka dorëzuar. Ata e kanë marrë e kanë malltretu me javë të tëra, saqë thuhet një kohë të gjatë ka qëndruar në shtrat. Ajo koha, periudha që sa herë kemi biseduar me gjyshin ka qenë ma e vështira. Aq shumë i kanë rrah, aq shumë i kanë shti në burg, i kanë zhveshë e i kanë fut nëpër akull sa... osht' ni histori shumë e tmerrshem dhe e dhimbshme që ma ka tregu gjyshi.

**Anita Susuri:** Si fëmi a keni pasë kontakt? A keni ardhë në Kosovë për shembull me nejtë ose... po mendoj para se me u zhvendosë ktu?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po, kemi qenë. Po pikërisht ajo arsyeja që ndoshta gjithmonë ne kokën e kishim knej, se vinim te daja, vinim te gjyshi. Edhe kjo... vendi ku shkonim te daja ka qenë hekurudha këtu, zakonisht treni ndalej aty. Më kujtohet kur zbritnim dhe gëzimi jonë ishte që po shkojmë te dajta atje. Atje ka qenë, thashë, klima ka qenë ma e ngrohtë, gjelbrimi ka qenë më pak dhe kur vinim ktu në fshatin Koshare ka qenë ni mrekulli për ne që dilnim dhe loznim me fëmitë e tjerë.

**Anita Susuri:** Qysh u bo që jeni kthy prej Shkupit ktu? A ka qenë për shkak se baba që ka dashtë me punu?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po, sipas asaj që më ka tregu baba, ai vazhdimisht osht' frigu që fillunë atje... në Maqedoni frikësohej se a do të vazhdojmë ne me shkollën shqip atje, sepse ktu u hapën fakulteti, u hapën shkollat e mesme, shkollat, domethonë, filloi shkollimi në gjuhën shqipe. Ai donte të na sjellte në Kosovë që ne të vazhdojmë në gjuhën shqipe të shkollohemi dhe të jetojmë në këtë rrethin ktu. Sepse i kishim edhe familjartë e tjerë e të gjitha kto për të vazhduar.

**Anita Susuri:** Ju jeni kthy në Ferizaj, keni vendosë me ardhë...

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po.

**Anita Susuri:** Po mendoj prindët...

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po prindët se ne kemi qenë të vegjël.

**Anita Susuri:** Qysh ka vazhdu pastaj, qysh ka vazhdu pastaj jeta?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Në Ferizaj?

**Anita Susuri:** Po.

**Shahadije Neziri Lohaj:** Jeta, një kohë ka qenë ndoshta edhe ne kemi qenë të ri dhe nuk e dinim, fëmi dhe nuk e dinim që po ndodhnin gjëra të ndryshme në Kosovë. Mirëpo, kur u bëra për me ditë e pam që nuk funksionon ashtu si ne kemi mendu. Sepse me të thanë të drejtën, atëherë përveç asaj që ishim nën sundimin e Jugosllavisë e cila zakonisht ai i avanconte republikat e tjera ndërsa ne kemi qenë krahinë në atë botë. Krahinën tonë nuk e avanconte në asni aspekt. Fillum ta kuptojmë, fillunë organizata të ndryshme të vepronin nëpër Kosovë. Ato ndjenjat patriotike, ndjenjat atdhetare që i kemi pasë fillunë edhe te ne të lëvizin gjërat, t'i shohim ndryshe gjërat. Atëherë edhe ne u organizum në grup...

**Anita Susuri:** Çfarë moshe keni qenë kur fillimisht keni kuptu që po ekzistojkan ksi organizata?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Kam qenë në klasën e tetë. Në klasën e tetë i binte ajo mosha, sepse ne shtatë vjet përpara na shtinin në shkollë. Kam qenë 15 vjeçare ndoshta, 15 vjeçare kam qenë kur e kam kuptu sepse në vitin '81 filluan edhe demonstratat në Kosovë. Grupacionet e mahershme ishin edhe në vitin 1979-ën kur u burgosën disa nga të rinjtë ktu në Ferizaj. E që neve na lanë ato menjëherë mbresa çka ndodhi, pse u burgosën. Ne fillum të hulumtojmë, të shohim çka nuk osht' t'u funksionu. Pastaj filluan demonstratat e '81-tes.

Në demonstratat e '81-tës kam marrë pjesë edhe unë. Ishim në shtëpi, dëgjuam që ka një demonstratë. Isha e re, domethonë sa i kisha mbushë ndoshta 15 vjet e diçka kështu. Nëna më tha, “Mos dil”, më tha, “se nuk bon aty me dalë, je e re ti”. “Po, po”. Edhe unë edhe vëllai ikëm dhe dolëm në demonstrata. Më kujtohet kjo pjesa te hekurudha ktu se tash ka ndrru ajo, mirëpo te hekurudha ka qenë grumbulli i njerëzve të cilët u mblodhën edhe ne filluam aty u futëm, filluam brohorimat e ndryshme, “Kosova Republikë”. Sepse donim që edhe Kosova të jetë republikë si të gjitha republikat e tjera dhe të ketë të drejtat e barabarta me republikat e tjera.

Filluam të brohoritshim, “Trepça është e jona”. E cila edhe sot osht', ju po e shihni që synimi është te Trepça. Shokët nga burgu pastaj sepse i burgosën disa. Kishte brohorima të ndryshme edhe unë isha pjesë me gjithë vëllain. Pastaj, u hodhën gazlotsjellësat, filluan policia të intervenonte, të ju mshonte, t'i shtynte demonstruesit dhe atëherë u shpërndam. Me të thanë të drejtën gazlotsjellësit ishin aq të tmerrshëm sa të ngulfatke. Kishte persona që kishin qenë ma të përgatitur, ma të pjekur që thoshin, “Mere qepën afroje afër hundës që të largohet ajo”. Domethonë, helmi që na kishin qit'. Ikëm nga aty dhe u kthyem në shtëpi.

Kishte, pat' burgosje të tmerrshme, pat' vrasje. Dy nga tanët u vranë, u vra Sherif Frangu... u vra Riza Matoshi, u burgosën shumë të ri e të reja. Shumë të tjerë u përjashtuan nga shkolla dhe prej aty filloi një jetë krejt ma ndryshe në qytetin tonë të Ferizajit. Ne e pam se në Kosovë, e pam se Kosova, në Kosovë po bëhen gjëra shumë të padrejta. Filluam atëherë të organizohemi. Unë, vëllai dhe disa shokë e shoqe në vitin 1982 u organizuam dhe krijuam grupin “Shote Galica”. Secili nga anëtarët tonë do ta bënte grupin e vet dhe ajo treshja do të shkonte, si lloj zinxhiri kjo ka shku.

**Anita Susuri:** Sa veta keni qenë në grup?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Në grupin tonë kanë qenë të përfshirë kta persona, Fatmir Neziri, unë, Florie Hajrullahu, Hyzri Osmani, Naim Hajrullahu, Naim Sadiku, Nadije Ramadani. Grupi jonë ka pasë, kur e kemi formu grupin tonë ne kemi bo edhe betimin me flamur. Jemi bo bashkë dhe kemi dalë prapa shkollës, ka qenë Qendra II, atje te Bill Clinton që tash osht' salla e sportit. E kemi marrë flamurin dhe jemi betu në atë flamur që ne do të vazhdojmë rrugën deri në çlirimin e vendit tonë.

**Anita Susuri:** E për që është bo betimi, qysh e keni ditë që është dashtë me bo atë betim?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po ne kishim dëgju, sepse vazhdimisht në Kosovë bëheshin, kishin fillu kjo fryma që njerëzit të punojnë për çështje kombëtare, për çlirimin e vendit. Dhe duhej aty të ishte shumë i sigurt, sepse nuk guxoje ti të merrje dikë tjetër dhe mrena ditës ndoshta edhe burgoseshe. Kështu që, secili prej neve duhej të betohej që nuk do ta tradhëtonte shoku shokun, por do të vazhonte të vepronte ashtu siç duhej të veprojë dikush për çështjen kombëtare. Ne kështu u betum dhe fillum.

E patëm ni status në të cilin ne kishim si qëllim çlirimin nga Jugosllavia e asaj kohe, formimin e një republike të Kosovës, kishim... pastaj i caktum detyrat e tona që të ngritnim vetëdijen te rinia jonë, të lexonim materiale të ndryshme në të cilat tregohej realiteti i Kosovës, se si mbeti në Jugosllavi dhe mbeti jashtë trojeve shqiptare, si domethonë të vendit tanë që e kemi Shqipërinë. Pastaj, shkruanim parulla të ndryshme që Kosova... duhet populli të zgjohet, të filloj dhe të veproj dhe nëse vjen deri në fund edhe ndonjë, domethonë organizim tjetër. Për shembull, lufta që ne të shlirohemi nga okupatori jugosllav që ishte në atë botë.

**Anita Susuri:** Po më intereson kto, për shembull detyrat për me, aktivitetet që i keni bo, a i keni mendu ju vet apo ka ardhë dikush ju ka përcjellë te ju?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Jo, ne i kemi mendu vet se grupi jonë ka qenë nga ne i formum, jo që kemi marrë detyra nga dikush tjetër. Sepse, në atë kohë, thuhet se, ka zëra që thuhet që në grupin tonë organizata të ndryshme e kanë organizu. Jo, grupi jonë është organizu prej neve të rinjëve. Pastaj, ne i kemi zgjeru. Detyrat i kemi marrë sepse e kemi pa që duhet këto detyra të jenë për, për vendin tonë. Grupet e tjera pastaj, pas çlirimit kanë thanë që grupi i "Shote Galicës" ka qenë i lidhur me grupe ma të mdhaja. Ne *de facto* kemi pasë lidhje me ta, po nuk ka qenë lidhja për organizimin. I kemi njoftë, kemi bisedu, po ne kemi majtë sekret që e kemi grupin.

**Anita Susuri:** E anëtarët e grupit që keni qenë, keni pasë besim, po mendoj po se po, mirëpo keni qenë shoqni apo edhe me familje?



**Shahadije Neziri Lohaj:** Po, kemi qenë bashkë në shkollë, kemi qenë shoqëri, me familje. Përpos vëllain që e kam në familje, të tjerët janë shoqëri të shkollës që kemi qenë, nxënës të shkollës të mesme.

**Anita Susuri:** Ju thatë që keni shkru edhe parulla, a mundeni me na përshkru, për shembull, ni, si me thanë...

**Shahadije Neziri Lohaj:** Ni moment.

**Anita Susuri:** Ni aktivitet.

**Shahadije Neziri Lohaj:** Ni moment, po. Kemi, ne, unë me vëllain tim kemi dalë këtu në rrugën “Vëllezërit Gërvalla” i kemi shkru parullat dhe i kemi vendosë nëpër dyrë të shtëpive. Kuptohet se ajo ka qenë në mramje, jo ditën. Në mbrëmje i kemi vendosë. Niherë e kemi kqyrë territorin, sigurisht mos ka polici, mos ka persona të cilët ka mundësi me na lajmëru. Kemi vendosë aty, “Kosova Republikë”, “Duhet të çlirohemi nga zgjeba e Jugosllavisë”, edhe kemi shku në shtëpi. Për fat të mirë nuk na ka pa dikush tjetër, po pastaj policia i ka gjetë ato, i ka majtë. Dhe ma vonë kur na kanë marrë, sigurisht na kanë thanë, “A jonë të juvet?” Po ne s’e kemi pranë që janë tonat ato. Në fshatrat përreth si Florija, Hyzria, Naimi e Nadija kanë shkru parulla të ngjashme. Nëpër fshatra, domethonë të komunës sonë. Pastaj materialet i kemi lexu dhe ia kemi përcjellë njani-tjetrit.

**Anita Susuri:** E sa ka qenë vështirë për m’i gjetë edhe për m’i siguru kto materiale?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Shumë ka qenë e vështirë. Mirëpo, ne tu u njoftë me shokë tjerë i gjenim ato materiale sepse na jepnin, na huazonin. Edhe ata ishin të interesuar që ne të vepronim. Mirëpo, zakonisht e kemi majtë sekret, sepse s’guxonim me ju thonë që jemi në grup sepse po t’i tregoje ato pastaj zbuloheshin. Sa ma shumë që zgjerohej rrethi aq ma lehtë është me shku deri te policia e asaj kohe. Pastaj, filloi grupi të zgjerohej. Filloi secili të organizoj tjetrin. Unë e kisha ni treshe timen, vllau ashtu, Fatmiri, pastaj Hyzriu e të tjerët. Filloi grupi, domethonë, të zgjerohet.

Mirëpo në vitin 19... në shtator të vitit 1983, ni vit ne kemi vepru, neve na burgosën. Ka erdhi ajo ne akoma nuk e dijmë. Ne nuk mund të themi tash, kur na morën neve, mos, “Cili prej jush na lajmëru?” Nuk ka kuptim ashtu të thuhet, sepse kur ke hy ti në dorën e policisë, aty ndoshta edhe ka mujtë dikush me folë. Nuk ka kuptim as të bisedohet rreth asaj çashtjes për atë kohë. Nashta edhe kemi mendu, “Pse u dashtë dikush [të na lajmrojë]? A kemi thanë na që nuk do të thojmë për njani-tjetrin”. Mirëpo, si duket dikush i ka tregu dikujna dhe dikush e ka çu deri te policia. Ata na kanë përcjellë, na kanë burgosë...

**Anita Susuri:** A e keni vërtetë ju që po ju përcjellin?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Me të thanë të vërtetën nuk e kam vretjtë, kam pasë një dyshim në diçka, mirëpo derisa nuk kemi fakte të gjalla ne nuk guxojmë me thanë.

## Pjesa e Dytë

**Shahadije Neziri Lohaj:** Burgosja ka ndodhë me 21-tin në shtator [1983]. Unë kam qenë në orën e mësimimit, në klasë kur kanë ardhë policia dhe më kanë burgosur. Kanë ardhë dhe më kanë thirrë, jom çu. Thanë, “Po thirrë drejtori”. Bile u çudita, thashë, “Pse në orë të mësimimit me më kërkun drejtori”.

**Anita Susuri:** Sa vjet po i bjen që i keni pasë?

**Shahadije Neziri Lohaj:** ‘83-ta unë ‘65-ten tash duhet me llogaritë dikund 18 vjet, pa i mbushë, 18 mos i kom pasë të mbushne. Kur më thirrën poshtë atje te drejtori në zyrë, shkova. Atje kishte qenë inspektori polic dhe më thanë, “Duhesh me ardhë deri te...” Ata u sillën keq me mua, ashtu u sillë edhe drejtori. Më thanë, “Duhet me ardhë deri në inspektoriat”. “Po unë”, thashë, “t’i kryj orët e mësimimit se vij”. “Jo, jo, tash”, tha, “me neve”. Me ta më kanë çu në zyre [të Sekretariatit]. Tani aty kanë fillu ato malltretimet e tyre, kanë filluar pytjet, “Çka keni ba? Kush je ti? Çka ke vepru?” Me të thanë të drejtën kishin pasë shumë, kishin pasë fakte që ishin marrë.

Ndoshta secili nga pak, se ashtu e ka pasë strategjinë policia e atëhershme që na merrnin në hetime se ty t’u dukej se i ka thanë dikush. Ata e dinin, ata kanë qenë profesionalista për atë punë. Ata thoshin, “Të gjithë shokët e tu të grupit e kanë pranë që ti je kryetaraj e grupit”, unë thojsha, “Jo, nuk është e vërtetë që kam qenë kryetarja e grupit”. Ka ndodhë që ma kanë malltretu vëllain, ka ndodhë e dëgjoja zhurmën e malltremeve që ndodhte në pjesën tjetër. Mirëpo, asniherë s’e kam pranë që kam qenë. Mu ashtu më kanë dënuar, pa e pranë veprën. Edhe pse ata me fakte zbulohesh, sepse dihej që grupi kur u zbulu ishin emrat që i kishin gjetë aty të grupit, që e kishim listën tonë. Na burgosën, domethonë më burgosën.

Ditën e parë më kanë mbajtur në Ferizaj. Pastaj na kanë qitur në koridor aty të gjithëve, pothuajse na shpërndajtën. Secili nëpër burgje të tjera. Neve vajzave na dërguan në Burgun e Mitrovicës. Atje pastaj kanë vazhdu hetimet ende. Vazhdimisht na kanë marrë në pyetje duke na pytur, “Çka keni bo? Çka ka bo ai shoku? A ka vepru? Kush i ka shpërnda këto pamfleta? A janë të juat, a s’janë të juat?” Në grupin tonë janë përfshi edhe dy persona të cilët nuk kanë qenë në grup. Ata janë dënu edhe kanë marrë dënime mjaft të larta. Sigurisht edhe ata kanë vepru, po s’kanë qenë pjesë e grupit tonë. Aty dy, kanë qenë një Fatmir dhe një Selim të cilët janë bashku grupit tonë në dënim kur është dhanë. Mirëpo, pjesë e grupit jo edhe pse ata akuzohen se kanë qenë pjesë e grupit tonë. Por, nuk kanë qenë pjesë e grupit tonë.

Ne, me thanë pas katër mujve a pesë, se si të mitur që keni qenë, unë kam qenë e mitur madhore mirëpo vëllai im ka qenë i mitur sepse ai ka qenë diku 16 vjeç. Nadire Ramadani po ashtu ka qenë diku pa i mbush 16 vjet. Këta të tjerët pothuajse në moshën time kanë qenë. Ata, Nadirja u dënu me dënim për të mitur, prej njëve deri në pesë [vjet]. Vëllai e ka marrë dënimin e të rriturit. Ne jemi dënu nga Neni 136, me aline një lidhur me 114, që do të thotë që ata s'kanë pasë të drejtë ata me na dhanë dënimin sepse kemi qenë kryesisht të mitur në grupin tonë.

Gjykimi ynë ka qenë i mbyllur, nuk kanë lanë as gazetarë, mezi na kanë lonë prindërit aty të jenë prezent kur na kanë gjykuar dhe na kanë dënuar. Gjykatëse ka qenë Fëllanza Kadiu, e cila edhe sot vepron dhe në këtë shtetin tonë të lirë. Vepron dhe i gjykon njerëzit. Kjo mua nganjëherë më brengosë, se pse pikërisht në atë kohë kur ajo ka dënuar të ri e të reja, të veprojë dhe të jetojë me po atë privilegj që e ka pasë në atë kohë. Ndoshta ka qenë detyrë, mirëpo mendoj që kjo është e rëndë prej neve që e kemi përjetu dënimin prej saj.

**Anita Susuri:** Po më intereson për prindët e juj, a e kanë ditë ata që ju jeni në aktivitet?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Me të thanë të drejtën nuk e kanë ditë ata. Edhe tash shpesh nana më thotë, “Diçka kom pasë vretë që u bo, po nuk më ka shku menja që jeni t’u vepru me naj grup”. Mendoja që ndoshta veç janë t’u bisedu kto biseda patriotike po që jemi organizu nuk e ka ditë. Tash shpejti më ka tregu, tha, “Kur erdhën policia dhe e bastisën shtëpinë”, tha, “më pytën, ‘A e din çka janë t’u bo fëmija tu?’ Thashë, ‘Kurgjo, janë t’u shku në shkollë’ edhe”, tha, “e çoj tepijen, ju kishit pasë plot parolla aty që i kishit pasë shkru dhe kishit pasë me i shpërnda. Edhe i kapën”, tha, “ato parulla edhe thanën, ‘Shih çka kanë shkru fëmijtë e tu. Janë kundër shtetit’. U frikësova shumë”. Sepse ishte familje e persekutuar që nga lindja, nana ime.

Neve mrena qasaj dite na burgosën te dy edhe vëllain edhe mu. Vëllai ka qenë në Prishtinë në shkollën e medicinës, unë isha në Ferizaj. Ata bile e pritën derisa erdhi, a mu më morën në orën e mësimin. Për prindët e mi ka qenë e vështirë, sepse ata duhej të kujdeseshin për dy fëmijtë. Pastaj aty veç filloi ajo të, persekutimi i hapur i familjes time. Ishte frika se do të përjashtohet nga puna babai i cili na mbante, ishte mbajtës i familjes. Pastaj, ishte frika që të përjashtohet nga puna edhe motra ime, Drita, e cila kishte filluar punën, sapo pat’ filluar punën si infermiere.

Nuk ishte e lehtë që ata të vazhdonin edhe të vepronin, të jetonin në liri. Me e qurtë liri në thojza, ndërsa ne në burg. Për ata nuk ishte e lehtë me ardhë në vizitë dy herë në mujt, herë te vëllai, në Mitrovicë te unë, ndërsa te vëllai në Gjilan. Shumë e vështirë. Për të ardhë në vizitë duhej të mirrej leja prej gjykatësi, duhej të lihej puna. Prej atyhit me ardhë te unë në vizitë në Mitrovicë, ju e dini, përpara lidhjet me autobus nuk kanë qenë siç janë tash, kanë qenë ma të vështira. Pastaj, të shkoje në Gjilan.

Pastaj, mua më transferuan në Lipjan. Pak u lehtësu familja ime sepse Lipjani ishte afër. Ndërsa vëllain tim e çunë në Gjyrakoc, afër Durbavës. Dy orë rrugë bëhej të shkoje. Dy orë veç me shku se jo me u

kthy, me qëndru aty. Për familjen time kishte fillu ni jetë shumë e vështirë. Mirëpo, kur e dinin ndoshta edhe kjo ideali i lartë i ka mbajtur ata edhe na ka mbajtur edhe neve. Asni vizitë asniherë nuk na ka humbë, na kanë ardhë te dyve.

Bile vizita e parë që e bonën prindët e mi, që erdhën, unë e pyta, “Si është?” Për vëllain e pyta, “Si është Fatmiri?” Se nuk e dija çka ka ndodhë me vëllain, se e dija që e kanë malltretu shumë. Ma ndërprejtën vizitën meniherë dhe nuk... [më] thanë, “Edhe niherë nëse e bon pyetjen nuk të lejojnë ma vizita”. Ma ndërprejtën vizitën. Prindët e mi u kthyn. Ata tashti m’i tregojnë peripetitë e tyre se sa kanë hequr derisa kanë ardhë, mirëpo ishte një çështje shumë e madhe, madhore çështja për lirinë e atdheut. Ne i kemi përballu edhe familjartë edhe ne me dinjitet.

**Anita Susuri:** E zakonisht sa kanë zgjatë këto vizita? Po më duket shumë pak.

**Shahadije Neziri Lohaj:** Vizitat që i kemi pasë në Mitrovicë kanë qenë përmes grilave, jo të hapuna siç jemi ne tash t’u qëndru tash. Aty lejoheshin vetëm dy anëtarë, eventualisht tre të familjes. Bisedat që ata i kanë mendu që ndoshta janë të ndaluara të pësësh për persona tjerë ose për vëllain që e kisha të burgosur nuk ishin të lejume. Ajo ka zgjatë diku dhjetë minuta ma së shumti vizita. Ndërsa në Lipjan kur më kanë transferuar në shtëpi edukuese e kanë qujtë kta, korrektuese aty i kemi pasë një orë, gjysë ore, një orë vizitat dy herë në mujt. Edhe në Mitrovicë ka qenë dy herë në mujt, po nga dhjetë minuta.

**Anita Susuri:** Më tregutë për dhunën që ka qenë psiqike, keni dëgju rrahje, po po më intereson edhe dhuna fizike ndaj juve, a ka qenë shumë? A ka qenë e randë?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po, ka pasë edhe dhunë fizike. Edhe ndaj meje po edhe ndaj të tjerëve sepse ajo bërtima, për shembull që i rrahnin ka qenë dhunë fizike. Nuk ka mujtë njeriu me bërtitë pa e rrah. Se ata zakonisht i kanë përdorë këto shufrat që i kanë pasë ose ndoshta edhe me dorë a kush e di. Kanë bo malltretime.

**Anita Susuri:** Edhe ndaj juve ka pasë?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po, ka pasë, po jo ashtu me thanë sa me humbë, me qenë ndonjë vetëdije ose diçka. Ka pasë dhunë.

**Anita Susuri:** E në Burgun e Mitrovicës që thatë, a keni qenë gjatë hetimeve apo edhe...

**Shahadije Neziri Lohaj:** Burgu i Mitrovicës është qujtë paraburgim. Aty janë zhvillu hetimet. Kanë ardhë inspektorat, na kanë marrë inspektorat e ndryshëm në pyetje dhe prapë na kanë kthy në burg. Personalisht për vete tash po flas. Në ditën e parë që më kanë dërgu nuk e kisha idenë se çka është burgu. Pastaj, isha rritë me ni familje me kushte shumë të mira dhe na mbanin prindërit ndoshta si në

ditët e sotshme si i kqyrim na fëmitë, si kujdesemi na për fëmitë sot në këtë kohë. Më morën dhe më çunë aty.

Më mori gardianja, “Hajde”. Edhe po më hypin dikund në katin e dytë sa e di edhe po më shtijnë në ni vetmi. Një vetmi ka qenë një metër e gjysë me dy edhe ni dritare e vogël ndoshta me thanë 40 centimetra edhe vetëm me dy druna kështu ka qenë. Ni batanije e grisun plotësisht ku lodronin minjtë. Nuk kishte, e kishte diçka të plastikës për ta shërbyer për tualet, për nevojat personale. Pastaj, muret i kishe të gjitha të shkruara me vija. Kur më shtinin aty thashë, “Pse ktu?” Ajo veç kështu me dorë ma boni {bën me dorë në shenjë të hy brenda}.

Meta unë aty dhe po vazhdoj po e analizoj murin, dritaret, dyert që u mbyllën, po i numëroj vijat. Kishte qenë Halil Alidema në atë vetmi, diku, nëse nuk e kam gabim ndoshta 57 vija sigurisht 57 ditë kishte qëndru. Ajo vetmi ka qenë jo dhomë e burgut, por që i linin vet të burgosurit. Fillova t’i mshoj derës shumë me të madhe, “Hapma derën, pse duhet ktu unë të qëndroj?” E dëgjova një trokllimë në mur dhe një zë i një burri dikujt i cili më tha, “Mos trokit në derë sepse ka mundësi me u kthy gardianja e me të malltretu”. Pastaj u nala.

Qëndrova aty një natë, ishte e tmerrshme ajo qëndrimi i asaj nate. Ushqimin që e sollën e sollën të tmerrshëm. Aq i dobët sa nuk kam fjalë me përshkru. Unë fillimisht nuk e mora ushqimin, as në darkë. Mirëpo të nesërmen vazhdova. Dhoma ishte me përshkru gjithë myk, minjtë dilnin e hynin. Ku e di, ku e kishin gjetë ni pjesë tjetër. Bile e kam një poezi në të cilën thom, “E vetmja gjë që unë aty pashë ishin minjtë”, edhe them, “unë ua prisha qetësinë atyre se ata e kishin vendin aty” (qeshë).

Pastaj, ditën tjetër më morën dhe më futën në dhomën numër tre ku aty gjeta disa të burgosura. Ato të burgosura që disa kishin qenë për vepra të tjera, jo politike. Njëra ka qenë për vepër politike, ka qenë Naxhije Hajrullahu. Ajo ka qenë e komunës së Vitisë, tash jeton dhe vepron në Ferizaj. Aty Burgu i Mitrovicës ndoshta është ndër burgjet ma të tmerrshme që kanë ekzistuar ndonjëherë edhe s’besoj që do të ekzistojnë.

Dhoma ishte, ma keq s’ka pasë se qysh me qenë. Një e plastikës, njëfarë si kante kështu që shërbente për nevoja tona. Dritaret kanë qenë shumë të vogla, të cilat nuk ke mujtë as me i mbrri atje. Pastaj, ato çarçafet kanë qenë të tmerrshëm, të vjetër. Batanijet kanë qenë aq të vjetra sa ndoshta njeri ka mujtë vetëm në filma me i pa. Po të hynte gardianja ishte rregullorja që ne t’i vendosim duart mbrapa, ta ulnim kokën dhe të mos i shikonim në sy.

Një herë në ditë na qitnin në banjo, aty t’i krynim shërbimet tona. Pastaj, njëherë në ditë na kanë qit në shëtitore e cila ka qenë e rrumbullakët, kesi soji të silleshim. Na linin aty, pesë minuta, dhjetë ma së shumti. Nuk guxojë ta çojë kokën lartë sepse të dënonin me ato ose edhe të rrahnin. Me folë mes vete me za të ulët, çoheshe në ora 5:00 të mëngjesit dhe nuk guxojë të uleshe në ata shtrata sepse ishte

ashtu rregullorja. Ushqimi ka qenë jashtëzakonisht i dobët. Mirëpo, ne kishim ni qëllim dhe atë e tejkalonim.

Ka ndodhë që gardianët kur nuk ishin aty, ato dilnin prej pavijonit, ne e dinim që janë edhe tri dhoma të tjera aty. Komunikonim me njëra-tjetrën, bënim ato shenjat që thashë, ishte një trokollimë që ishte ajo shenja e të burgosurve. I binim asaj shenjës dhe fillonim pastaj. Ato secila ia linim emrin, një pseudonim njëra-tjetrës. Mua ma lanë pseudonimin “Besa”. Kur më thirrnin në dhomë bisedoja me to, ato me mua. Po kur vinin gardianet, ne ndaleshim sepse ajo dera, dhoma e fundit që e dëgjonte atë *tik takun* {onomatope} e gardianës, domethonë të takës, menjëherë na lajmëronte dhe ne ndaleshim.

Kisha një moment me nda me juve se si më më zuri njëherë gardianja duke biseduar me një, me dhomat e tjera. Ajo u bo se kishe ka dalë, mirëpo nuk kishte dalë. Po gardianja që ishte, gardianja Emine ishte një ndër gardianët ma të mira që sillej me neve, ajo kishte qat’ ndrrim. Po ndrrimi që ka ardhë tjetri, ka qenë një Fevzije. Ajo ka qenë një ndër gardianët më të tmerrshme që njeriu mundet me përshkru. Një nga personazhet më të tmerrshme. Ajo kishte qenë në dhomë Eminja dhe kjo ka ardhë dhe më ka dëgju mu duke komunikuar me atë shoqen tjetër të dhomës.

E hap derën, më ngreh zhag edhe më çon në dhomë. Ajo e shikon, thotë, “Çka u bo?” Kjo Eminja, gardianja Emine po i thotë gardianës Fevzie. “Tash”, thotë, “ka me bo llo”, kështu ajo e ka pasë fjalorin. Po e merr pendrekun për me më rrah, me më rrah mu. Po ajo i tha, “Jo”, tha, “ti nuk guxon kta me e prek” tha, “sepse osh’ ndrrimi im. Ti në ndrrimin tim munësh me e rrah, por unë do ta boj ni raport që m’u ke përzi në punën time”. Ajo u ndal po e shikon edhe e hodhi kështu edhe tha, “Unë ka me të zanë ty” (qeshë).

Faktikisht ajo mua më shpëtoi nga ajo gardianja. A kanë pasë ato dyja mes vete apo kjo e ka pasë atë shpirtin ndoshta ma të mirë që neve, që sillej me neve më mirë. E rëndësishme mua atë ditë më shpëtoi dhe më futi në dhomë. Kështu, janë disa peripeti që njeriu ndoshta me i nda me njerëzit. Nuk janë të lehta.

**Anita Susuri:** Ju thatë që ju kanë dënu si grup...

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po.

**Anita Susuri:** Sa ju kanë dënu juve?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Mu më kanë dënu tri vite dhe i kam mbajttë te trijat pa falje. S’kam pasë ndonjë falje ose ndonjë zbritje të dënimit. Është vërtetu ai gjykim dhe ato të gjitha i kam mbajttë. Diku pesë muj i kam mbajttë në Burgun e Mitrovicës, pjesën tjetër e kam mbajttë në Lipjan. Në Burgun e Mitrovicës ndoshta ato momentet që unë nuk kisha dashtë kurrë t’i kujtoj, por mirë është me i ditë

njerëzit dhe do t'i përmend. Ka ndodhë që aq shumë i kanë rrah të burgosurit lart sa ndoshta shpesh herë unë i dëgjoj ata zëra të atyre të burgosurve.

Pastaj, ni moment që mu nuk më hiqet nga menja është edhe momenti kur kemi bo grevë urie tri ditë për pushkatimin e Ferat Mujës. Ferat Muja kishte qenë ni person që kishte vra dikë nga serbët dhe e ka marrë vendimin gjykata që ta pushkatonin. I kishte ardhë dënimi Ferat Mujës që do të pushkatohet, do të ekzekutohet atyre ditëve derisa të bohet, domethonë vendimi i plotfuqishëm. E dëgjuam ni thirrje që u bo, “Vini re, nesër do të fillon greva e urisë sepse ka ardhë vendimi i plotfuqishëm që të pushkatohet”, edhe data po s’më kujtohet, “Ferat Muja”.

Ne kemi bo tri ditë grevë urie, mirëpo si duket Ferat Muja është pushkatuar. Pastaj tjetri, tjetra ishte edhe një grevë e kemi bo edhe për vrasjen e Rexhep dhe, Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës, që ishte bo edhe aty disa ditë, që u bo vrasja ndaj tyre. Mirëpo, këto grevat e tona ishin vetëm protesta sepse askush nuk i dëgjonte, nuk i intereson ajo pjesë se a bon ti grevë, a nuk bon. Ata prapë e çonin punën e tyre.

**Anita Susuri:** Po më intereson, qysh ka ardhë deri te ju këto lajme që janë vra, për shembull Rexhep Mala?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Na binin shtypin e përditshëm. Ne kemi pasë shtypin, e binin edhe i lexonim. Po ndoshta edhe ata kanë qenë të interesum që ne me i pa kto gjana edhe pastaj e dinin menjëherë që pasonin grevat. Dhe kond e kishin ata që mendonin që dikush është më i rrezikshëm se tjetri ose më i ndikum, më ndikuesi se tjetri merrnin masa ndaj atyre personave.

**Anita Susuri:** Thatë që ju kanë dërgu pastaj në Burgun e Lipjanit me e mbajtë dënimin e plotë. Si ka qenë atje?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po, pas katër muaj e gjysë më kanë dërguar në Burgun e Lipjanit. Aty kanë qenë kushtet ma të mira se në Burgun e Mitrovicës. Kanë qenë pothuajse të gjitha ato që ishin të dënuara të burgosura politike, po edhe të veprave të tjera. Kushtet aty kanë qenë të mira. Ka qenë ni oborr i bukur, ku ne kishim mbjellur lule edhe të burgosurat para meje. Ka qenë salla e leximit. E kemi pasë TV sallën. Dhomat në të cilat flenim nga pesë-gjashtë të burgosura. Kemi pasë sallën e edukatës fizike. Pastaj na vendosën edhe të punojmë me, domethonë në punëtorinë që kishte qenë e rrobaqepësisë aty. Unë kam punuar deri në lirimin tim nga burgu në atë punëtori.

**Anita Susuri:** A ka pasë ndonjë kompenzim apo?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po, ka pasur kompenzim, ka qenë ajo shumë simbolike ka qenë. Nuk muj me marrë parasysh sa, po ka qenë simbolike. Ajo punëtoria që ka qenë ka qenë e udhëhequr nga, më duket nga Fabrika e Konfeksionit nëse është e Gjakovës, nga një mbikqyrës që ka qenë ni Mujedin

Mulliçi nëse më kujtohet. Aty pastaj neve na e dhanë edhe vitin e tretë të shkollës së mesme sepse unë e kisha pa përfunduar, drejtimi tekstil i konfeksionit. I ndjekur me mësim të përsheptuar, vinin profesorat nga Gjakova. Disa aty që kanë qenë i kemi mbajtur dhe pastaj i kemi bo diplomën dhe e kemi përfunduar. Mirë ka qenë në Burgun e Lipjanit, nuk kanë qenë kushtet e vështira. Mirëpo, veç duhej t'i qëndroje rregullores të cilën ata e kishin parapa që ne çka duhet me ba edhe çka ishte e ndaluar për mos me ba.

**Anita Susuri:** A ju kujtohet ndonjë rast që kishit veçu që ka ndodhë?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po. Ka qenë ni rast, ndoshta edhe i dhimbshëm sepse ne në punëtori që punonim aty duhej të realizohej norma të cilën ata e caktojshin. Ka qenë Ajshe Gjonbalaj e cila kishte qenë atë ditë, nuk kishte mujtë mjaftueshëm me punu. Njëra nga ato mbikqyrëset që na mbikqyrke aty punën që e bonim e detyroi që ajo të çohet dhe ta hekuroste flamurin e Jugosllavisë, gjë që Ajsha nuk e bëri. Plus i thoshte, “Ti nuk po e kryen normën”, Ajshe Gjonbalaj e burgosur politike. Ajo reagoi, Ajsha, pastaj erdhi policia, gardianët e tjerë dhe e morën Ajshën. Na morën të gjitha neve dhe fillunë të... ne u detyruam ta bënim grevën e urisë, sepse ato i morën, i largun e dërgun diku. Po si duket e dërgun në Pozharevc. Ne pastaj bom grevën e urisë diku katër ditë nëse nuk jom gabim, tri ose të katërtën e ditës mos e kemi përfunduar.

I hoqën edhe disa nga shoqet e tona që mendonin që janë më me ndikim te shoqëria aty. I dërguan në Mitrovicë dhe neve të tjerave aty qëndruam në Lipjan. I morëm nga një muaj vetmi. Kemi qëndru pastaj në vetmi. Ka shumë gjëra. Ne aty në burg kemi kalu, me shoqëri, kemi kalu mirë. Kemi pasë libra të cilat i kemi lexu, na kanë sjellë libra nga shtëpia. Kemi pasë bibliotekën aty, kemi lexu, kemi, edhe punën e kemi kry, kemi respektu njëra tjetrën. Gardianët mirë janë sillë, kryesisht mirë. Nëse e ke thy rregulloren, atëherë sigurisht që nuk është lejua. Është dashtë me ju përmbajtë atyne rregullave, përndryshe ke pasë ndëshkime.

**Anita Susuri:** E qysh ka qenë ato ni muj që keni nejtë në vetmi?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Nuk e di. Nganjëherë kur bohet kjo pyetje, “Si ka qenë?” Nuk, kur e tregoj kështu me kto fjalët e mija osht’ shumë e thjeshtë. Rrin ni muaj në vetmi, rrin aty edhe... mirëpo, janë shumë të gjata ni muj, janë tepër të gjata. Unë kam qenë... aq shumë pati të burgosura sa nuk na zuri vetmia. Mu edhe [Havën Shalën](#) na vendosën në ni vetmi. Hava vazhdimisht recitonte poezi, unë recitoja poezi. Na qitën në shëtitore me u sillë aty si zakonisht në atë rrethin. Po e di që veç erdhën e morën Havën dhe e dërgun, e largun nga Lipjani. Unë mbeta aty në vetmi me vazhdu pjesën tjetër të dënimit. Nuk ka qenë e lehtë sepse ke pasë vetëm ni batanije, ke pasë vetëm muret. Nuk ke pasë ku të shtrihesh, ke pasë tualetin e ke pasë aty mrena, minjtë silleshin. Nuk ishte e lehtë, mirëpo ato idealet kanë qenë të larta tonat dhe ne i kemi qëndru. Ndoshta edhe i kemi tejkalu shumë lehtë dhe thjeshtë i kemi kalu.



**Anita Susuri:** Që thatë e keni pasë edhe sallën për televizion, çka ju kanë lëshu?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po zakonisht programet që ishin, apo të cilat kanë qenë televizionet të asaj kohe. Aty jemi mbledhë, kemi bisedu me njëra-tjetrën. Zakonisht bonim, tubimet që i bonim lexonim libra, i komentonim me njëra-tjetrën. Mirë kemi kalu me të burgosurat.

**Anita Susuri:** A ka pasë edhe si uniforma apo?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po, i kemi pasë uniformat e burgut, ato osht' dashtë me i veshë kur kemi dalë jashtë pavionit. Mrena pavionit mujshim me nejtë edhe me këto sportivet apo veshjet që neve na kanë konvenu. Po rrobat i kemi la aty vet, nuk na kanë la të tjerët. Kuzhina ka qenë me ni pjesë krejt tjetër që na dërgonin atje. Dashta edhe diçka me tregu, ni ngjarje që mu m'ka ndodhë aty. Ishte, kisha shkru, unë mirrem me shkrime, me poezi. Kisha shkru disa poezi të mijat, të mira që ato më dhimen që më kanë humbë po çka të bojsh. Shumicën i kam mbajtë në mend dhe i kam shkru pasi kam dalë nga burgu.

Njërën nga poezitë që e kisha shkru për Jusuf Gërvallën që ata nuk e kam atë poezi, ia kisha dhanë ni shoqës time me lexu. Ajo e ka lexu, po ajo s'ka qenë e burgosur politike, ka qenë për vepër tjetër. E kishte vendosë në dollapin e saj. Unë isha prej punës, isha shtri edhe po rrijmë aty. Vetëm kur e kom pa hynën të gjithë, me gardianë me tjerë që kishin thirrë në ndihmë. Fillun me bo kontrollat, ajo bohej zakonisht kjo, jo që kishin lajmëru diçka për shkrimet e mija por diçka ndodhi rastësisht ajo edhe i mblodhën të gjitha çka gjetën aty të shënume.

Po të gjindej, për shembull, ai materiali që mu ma zuri policia aty, gardianët që e zurën ti e merrje në atë kohë dënimin prej një deri në tre vjet. Ishte propagandë e llogaritnin këta. Kështu ka qenë ai dënimi, Neni 133. Po asaj ia kishin zanë poezinë. Shkum në edukatën fizike. Tash më hyri mu ajo gajla që do të më ndjekin, do të më çojnë në Lipjan, do të fillojnë hetimet e tjerë e tjerë. Po lujmë basketboll kur po vjen, ka qenë profesori Danush, jeton ai në Prishtinë tash, i edukatës fizike. Po vjen gardianja që qëndronte me neve, ishte nga ana e qytetit tim, e njifja me familje.

Po i thom, "Gardiane, du me ta thanë ni gja po nuk e di ti a munësh me realizu?" "Po", tha, "fol Dije", thashë, "Kështu kështu, kom shkru disa poezi dhe i kam shti me ni qese të najllonit aty të keksave dhe i kom disa poezi që nuk bon ato me u lexu prej drejtorisë", edhe tha, "Tani çka me të bo? A e ke ditë ti që je në burg?" (qeshë) Veç e shikova, nuk dita çka me i thanë. Vërtetë isha në burg unë, pse i kisha shkru. Po s'kishe mundësi mos me i shkru kur të vinte ai frymëzimi. Hyra në lojë prapë, ajo nuk më ka bo za. Njiheshim me të familjarisht. Kishte shku ajo i kishte hjekë atë qesen edhe ma gjujti kështu edhe tha, "Shko digje". Ajo ma e keqja ishte që e dogja me durë të mija krejt materialin edhe m'u dhimt.

Tash po e pyti atë, "Ku e ke lanë ti poezinë?" Tha, "Valla Dije, e kanë zanë poezinë tane", "Po a?" Edhe po më thirrë drejtoresha, ka qenë Drita Kuqi, jo Drita Kuqi. Shpresa Kuqi sepse Drita Kuqi ka qenë e

burgosur politike. Ka qenë Shpresa Kuqi edhe po më thurret. Po më ulë, “Dije”, tha, “a po më tregon”, tha, “e kujt osht’ kjo poezi”, tha, “edhe po du me ta lexu”, tha. Thashë, “Unë nuk di çfarë poezie?” Nuk e pranoja. “Hajde”, tha, “bone shkrimin”, edhe tash unë kisha shkru kështu edhe po shkruj tjetrën anë.

Tha, “Pse s’po e pranon?” “Po”, thashë, “s’osht’ poezia ime”, po tha, “Ti duhesh me më tregu a osht’ e jotja?” Thashë, “Nuk osht’ e imja”, “Nëse osht’ e jotja”, tha, “qenka ni poezi shumë e mirë se”, tha, “unë e kam pasë shok klase”, tha, “Jusufin”, edhe tha, “unë e kom këtë poezi, te unë e ki edhe kurdo në jetë kërkoje te unë poezinë”, thashë, “Po nuk osht’ e imja”. Se unë s’e pranoja ma atë poezi se ishte gjetë në ni vend tjetër, jo te unë. S’e pranoja poezinë, “Ku e di unë e kujt është poezia”.

Nuk e pranova poezinë, mirëpo asnjëherë nuk shkova me ia kërku as ish drejtoreshës. Tash nuk e di ku jeton e ku vepron poezinë të cilën ma ka zanë. Nuk ke mujtë me nejtë ti indiferent sepse nuk të linte, frymëzoheshe. Patjetër duhej të shkruaje diçka edhe pse ishte në burg, nuk duhej sepse e merrshe dënimin për veprimtari, për propagandë.

**Anita Susuri:** E që thatë edukatë fizike, domethonë që keni përfundu vitin e shkollës të mesme, krejt landtë i keni pasë si në shkollë?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Ato landët që kanë qenë për konfesion, ato lëndë i kemi pasë. Kemi pasë, kemi pasë edhe landë të tjera. E di që ka qenë marksizmi në atë kohë, gjuhën edhe lëndë e konfesionit. Ato i kemi dhanë si provime. Na kanë pytë edhe i kemi kry. Të gjithave, jo vetëm për mu. Ka qenë për të gjitha të burgosurat. Po fati ishte për mu sepse unë e kisha shkollën e mesme pa përfundu që mu diploma m’u dha. Ajo përpos që u dëmtova që humba tri vite të jetës në burg, kisha marrë një vit, që kur dola nga shkolla nga burgu atëherë vazhdova studimet.

**Anita Susuri:** Qysh ka ndodhë me dalë prej burgut? A keni dalë qat’ ditë që e keni pasë, a ju kanë liru ma herët?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Jo, pikërisht atë ditë që e kam pasë datën e caktuar për me dalë nga burgu unë atë ditë dola nga burgu. Ka qenë, zakonisht kur e lironin dikë nga burgu mblidheshim të tëra shoqet e organizonim ni festë, këndonim, kërcenim, recitonim. Bile, ka qenë Sanije Kaqkini që gotën e fundit që pinim e thente që thonte, “Të mos ktheheni ma ktu”. Ne e thirrim si Nënë Tereza, se ajo na rrinte gati shumë. Nuk ka qenë për vepër politike, po na ka qëndru shumë afër neve të burgosurave politike. Ditën që jam liru kanë ardhë prindët e mi më kanë marrë dhe jam kthy në shtëpi. Po nuk ka qenë e lehtë, se ni kohë, tri vite isha shkëputë nga rrethi, isha shkëputë nga shoqëria, nga familja. Isha mësu me ni jetë krejt tjetër. Mirëpo, njeriu është qenie që adaptohet dhe prapë e fillum aty ku e lamë, e vazhdumë.

## Pjesa e Tretë

**Anita Susuri:** Në cilin vit po i bjen që keni dalë?

**Shahadije Neziri Lohaj:** ‘86-ën në shtator, ‘86-ës. Kishte ndryshu shumëçka. Situata ishte mjaft e randë sepse kishte njerëz që nuk guxonin të na flisnin neve të burgosurve politikë. Ndoshta ka ndodhë që të na shihnin, ishin nëpër puna, sepse ata pastaj merrnin masa ndaj personave që shoqëroheshin me neve. Viheshin në shënjestër. Kështu që, nuk më vjen çudi edhe që nuk na flisnin. Asnjëherë nuk ua kam zënë për të madhe ata që nuk kanë folë. Po kish edhe shoqëri të cilën e kishim prapë. Kemi qëndru me ta, kemi vazhdu. Pastaj, kom vazhdu studimet, në shkollën e lartë ktu në Ferizaj.

**Anita Susuri:** Ju ka leju?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po, tash ktu du të dal te puna e shkollimit. U regjistrova në shkollën e lartë ktu sepse mu nuk m’u kishte dhanë aty vendim gjykata që: “I ndalohet shkollimi”. U regjistrova. I kisha në një, ishte një kojshi imi që ishte sekretar aty. Ishte Ali Buqinca i cili më regjistroi në shkollën e lartë, në drejtimin përpunimi i drurit. Me të thanë të drejtën nuk e doja atë drejtim, por më mirë diçka se fare. U regjistrova. Pas dy vitesh që unë isha në përfundimin e studimeve të mija erdhi vendimi që mu të më përjashton. Kishte ardhë ni vendim që m’u kishte ndalu shkollimi.

E kishin prurë në fakultet aty edhe Aliu po më thotë, sekretari, “Unë po t’i paraqes qito dy provimet që të kanë mbetë të fundit. Hyn jepi edhe kryje. Se të ka ardhë ni vendim që ty të ndalohet nga Komiteti Kranikor shkollimi”. Kishte dalë emri, listat kishin dalë. Kinse s’po e dijmë edhe ta përfundojmë. Mirëpo, profesori që unë nuk du t’ia përmend emrin sepse nuk dua t’ia përmend, kur hyra në provim më tha, “Ti nuk munësh me i dhanë”. Dy provimet i kisha te ai edhe me përfundu. “Nuk munësh ti”, tha, “me vazhdu me hy në provim se je e larguar nga shkolla, e ke të ndaluar nga Komiteti Krahinor shkollimin”.

Unë tash, nuk e dija çka t’i them atij vetëm këtë e di që i thashë, “Pse, ti punon në Komitetin Krahinor apo je profesor?” “Jo”, tha, “kaq, çu prej ktuhit sepse s’du me marrë përgjegjësi”. Edhe u çova nga provimi. Ajo më mbeti mu shkolla për dy provime pa e përfundu shkollën e lartë. Fillum pastaj kjo era demokratike në vendin tonë dhe me anë të profesorit, ka qenë të letërsisë popullore Shefqet Pllana, të cilin e njihja përmes miqve të tjerë, i cili më regjistroi në Fakultetin e Gjuhës dhe Letërsisë në Prishtinë. Aty i vazhdova studimet edhe pse kisha emrat gjithkund, po ai më regjistroi.

Fillova të jap diçka prej provimeve, ndoshta me thanë, pesë provime i dhashë mrena afatit. Mirëpo, fillunë prapë ato, mbyllja e shkollave, fillunë nëpër shtëpi. Unë isha martuar, linda fëmijën. Fillova me m’u ndërpre shkollimi, nuk mujsha m’i ndjekë ligjeratat, s’ mujsha m’i ndjekë studimet edhe pazova ni kohë. Pastaj prapë fillova. Mirëpo, filloi lufta. Kur filloi lufta prapë më mbetën provimet sepse u dënova

në mungesë, dy vite e gjysë. U dënova në mungesë që i ndihmova Ushtrisë Çlirimtare. Sepse unë ika, gjykimi u mbajt, mu më dënuanë. Ika në Maqedoni, nga Maqedonia në Shqipëri. Prapë m'u ndërpre shkollimi. Shkollimin pastaj e vazhdova pas çlirimit dhe e kam përfunduar.

**Anita Susuri:** Dashta me u kthye te kto që i përmendët, fillimisht te pjesa për martesën, si e ke njoftu edhe si u bo me kriju familje?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Në vitin '87 i ka ra, ne jemi njoftu me bashkëshortin tim edhe ai ka qenë i burgosur politik. E kam pasë afër aty dhe kemi vazhdu me to, njëherë ashtu shoqëri pastaj jemi martu. Kemi pasë fëmijën e parë, na ka vdekë fëmija i parë. Pastaj, jemi burgosë prapë unë e bashkëshorti im. Unë kam qëndru një javë ditë në hetime në Mitrovicë. Bashkëshorti im është dënu pesë vite. Unë jom liru nga burgu sepse, me t'hanë t'drejtën, jo që s'kisha vepru mirëpo bashkëshorti im kishte qenë ai që m'ka lidhë me grupin tjetër dhe s'e dinin. Ai e ka marrë gjithë atë veprën përsipër që faktikisht më ka shkarku mu prej veprës për t'cilën nuk jam dënu.

**Anita Susuri:** Pas kësaj ju sigurisht e keni pritë deri në vitin '90-të?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po, po. Ai pastaj i ka majtë këto vitet burg dhe është liru. Kur osht' liru ka qenë, osht' pasë bo nifare amnistioni i përgjithshëm sa e di unë. Unë kam qenë në Prishtinë në Pallatin e Shtypit aty me ni orë letrare me [Shukin \[Shukrije Gashi\]](#) edhe ka qenë Vezir Ukaj, ky poeti. Po i dëgjojmë lajmet, po ishin në gjuhën serbe. Ti e din që mbiemrin e ka para emrin mrapa edhe po thotë, "Janë liru nga burgu", po i njuhë edhe po thotë, "Rexhep Avdullah Lohaj". T'u mendu, "Kush osht' ky Rexhep", unë po ia boj. Ajo Shuki, "Oj Dije", tha, "po Avdullahu qenka liru". Ka qenë viti '90, '90-'91 nuk po më kujtohet saktësisht viti.

U ktheva në shtëpi, e pritëm atë ditë, erdhi nga burgu. Pastaj, fillim prapë jetën bashkë. Ne kemi vepru vazhdimisht me bashkëshortin deri, ndoshta edhe sot me pasë mundësi vazhdojmë veprimet për çështje kombëtare sa herë të është nevoja. Pastaj kemi pasë fëmijët. E kam djalin, Kreshnikun, është i martuar dhe ka fëmijë, e ka një djalë. E kam Kaltrinën dhe Yllkën. Kaltrina e martuar dhe ka një vajzë dhe Yllka akoma është pa martu.

**Anita Susuri:** Vitet '90-a thatë, domethonë që aktiviteti i juv ka vazhdu, po tash pak ka ndryshu, domethonë, osht' formu edhe në atë kohë ushtria. Domethonë, ka qenë fillimi edhe ju jeni angazhu tutje.

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po, unë kam qenë e angazhuar edhe në Lidhjen Demokratike. Kam qenë në kryesisht si në Kryesi ndoshta në Forumin Rinor, në Forumin e Gruas. Aty kemi vepru vazhdimisht derisa ka fillu, që fillunë grupet e para të armatosura që dolën në sipërfaqe në territorin tonë. Pastaj, unë kom fillu me i ndihmu Ushtrisë Çlirimtare me një shoqe timën, Zymrije Salihu. Ajo, i njëfishim disa ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare. Përmes [Zahrije Podrimqaku](#), me Zahrijen unë kom kontakti në telefon,

ndërsa Zymrija ia ka dërgu rrobat në Stacionin e Autobusave në Prishtinë. Zahrija është burgosë pastaj, por Zymrija nuk është zanë atë ditë. Mirëpo, një ditë e di që e rrethun shtëpinë time dhe erdhën më morën mu. “Eja, sepse ti je bashkëpunëtore me Zahrijen”.

**Anita Susuri:** Kjo ka qenë ‘97-ën?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Kjo ka qenë ‘97-ën, po. Ne kishim kontakt me Zahrije Podrimqaku, ajo ma dinte emrin mu edhe mbiemrin. Ndërsa rrobat ia kishte dërgu shoqja ime Zymrija te Stacioni i Autobusëve. Atje u burgosë, pas disa ditëve është burgosë Zahrija, sepse Zymrija nuk u burgos. Sepse nuk i kanë zanë aty në vendin, po pastaj i kanë kqyrë kamerat që e ka pa pjesën kur i ka dorëzu rrobat e tjerë. Mu më kërkun policia, domethonë pasi ndodhi burgosja e Zahrijes. Më morën në pyetje dhe në pyetje më mori Nada... Danica Marinković, mos ka qenë më duket inspektore apo hetuese në Prishtinë. Po fati që unë për mos me u burgosë ishte kështu.

Atë ditë që ato janë filmu duke i dorëzu rrobat, unë kisha udhëtu për Turqi dhe e kisha emrin, mbiemrin me dy fëmijtë në aeroportin e Prishtinës. Po më thotë ajo që, “Ti i ke dorëzu Zahrije Podrimqakut rroba të ushtrisë”, thashë, “Nuk osht’ e vërtetë që unë i kom dorëzu rrobat e ushtrisë”, “Po”, thotë, “edhe më çonin në kamë, shikonin”. Unë pak ma e shnoh, ajo shoqja tjetër ishte e dobët. Nuk ju ngjaja te fotografia që ata kishin aty. Thashë, “Unë mundem me ju faktiku nëse jeni të interesum që unë nuk jam ajo që i kam dërgu rrobat, sepse rrobat e ushtrisë unë nuk e kam idenë se çfarë ushtrie ose qysh”, se bëhesha asisoji, “sepse”, thashë, “unë atë ditë kom udhëtu për Turqi, ja ku e keni datën që po e thuni ju, unë kam qenë në Turqi. Ja ku e keni pasaportën muni me kërkun, me dy fëmijtë kam udhëtu për atje”. Se faktikisht nuk i kisha dorëzu unë dhe ajo përputhej në tërësi.

Ata, ajo si duket e kish pasë dikë në aeroportin ka kërkun dhe emrat, ti e di qysh mirren aty me emra me mbiemra dhe e kanë faktun që unë s’isha. Më lirunë atë ditë. Mirëpo, nuk ka shku ni javë ditë apo dy javë, tash ishte interesant që ajo shoqja ime erdhi ilegal banonte te unë (qeshë), a unë veç isha e përcjellur. Por ata e kanë përcjellë telefonin si duket dhe prapë. Fati nuk kam qëllu atë ditë te shtëpia, kam qëllu te nëna. Ata e kishin blloku shtëpinë, lagjen me më kërkun mu me më burgosë. Mirëpo, fqinjët e mi më kanë lajmëru.

Pastaj kom qëndru ilegal në Prishtinë te një familje më duket ka qenë vajza e Shaban Shalës në Prishtinë. Pastaj te Kodra e Trimave atje me ni familje tjetër, sepse dola nga aty shkum sepse e rrezikojta familjen shumë. Aty më ka vendosur Emin Kabashi profesori me [Flora Brovinën](#) ma gjetën vendin që u vendosa atje. Po aty kishte qenë ni familje që e familjes Jashari që kishin shpëtu, jo bash e Ademit apo ktyne po sigurisht e familjes të gjerë. Kishin qenë edhe ata të strehum në atë familje dhe ni motër e vëlla kanë qenë të Istogut edhe ata kishin qenë të ndjekur nga ushtria serbe. Unë nuk dija kah të shkoja, ilegal me dy fëmi, dy fëmi të vegjël. Shumë të vegjël i kisha fëmijët.

Kisha botuar një poezi një ditë për masakrën që kishte ndodhë për Jasharaj. Ma pruni gazetën profesori Emin edhe po e lexoja aty. E kishte marrë ajo një vajzë e familjes Jasharaj e kishte ngjitur në mur, në dollap, në derën e dollapit aty. Se ata ruheshin nga unë, unë ruheshin nga ata. Ishim në dhoma të ndryshme. S'guxonim të bisedonim. Mirëpo e kisha lonë gazetën përmi, ajo po e merr po e shfleton e tha, "E kujna osht' qikjo poezi?" Edhe po ma sheh fletorën që e kisha shkruar poezinë në fletore. Thashë, "E imja është". "Po a?" Edhe po më merr për dore, "Eja", tha, "ja", tha, "unë e kom marrë këtë poezi e kam ngjitur këtu, sepse t'u mendu", se ishte shkruar për Jasharajt, "e ti je kjo?" "Po". Po e pys, po më tregon që është e familjes, po edhe ata tjetër ashtu.

Me të thanë të drejtën, mendova që unë duhet të kthehem në shtëpi, sepse duke i ndjekur ata do të më zinin edhe mu se ne ndiqeshim në çdo hap. U ktheva në shtëpi pastaj nga Tërnpvci erdhën disa shokë të bashkëshortit tim më morën e më dërgun në Maqedoni. Në Maqedoni aty bisedova me disa prej disa deputetëve shqiptarë që m'thanë, "Nuk bon me qëndru këtu sepse t'kthejnë maqedonët si t'i bojsh ditët sa osht' e lejume. Duhet të shkosh diku tjetër". Atëherë shkova në Shqipëri, në Tiranë kam qëndru edhe në Durrës deri në ditët e çlirimit.

**Anita Susuri:** Qysh keni arritë me shku pa u gjetë? Me udhëtua në Maqedoni për shembull?

**Shahadije Neziri Lohaj:** E tash, kjo osht' ni histori tjetër. Ata, familjartë e mi më kanë dërgu në Gjilan. Në Gjilan ka ardhë ni familje e Tërnovcit më ka marrë dhe kush e di aty i ka njoftë ata personat që kanë qëndru te kufiri edhe kam kalu kufirin. Po tash ma e rrezikshmja ka qenë me tren kur kemi hyp te Tabanska aty për me kalu. Ata, familja nga Tërnovci dhe kam një përshtypjen që janë shumë patriotat, familjarë ajo pjesa andej. Si duket e pagujtën kufirin aty. I kanë njoftë ata persona, ju kanë dhanë diçka edhe hyra në zonën neutrale.

Thanë të drejtën e kisha pak frikën se dy fëmi i kisha të vegjël, njërin knej {bën me duar tek krahu i majt} njërin knej {bën me duar tek krahu i djathtë}. Pritsha që ata kanë me më burgosë mu kur hypa në tren te kufiri. Po ata nuk e futën fare këtë pasaportën në kompjuter, sepse aty e qitke me ngjyrë të kuqe që kjo e ka ndalesën ose e kanë njoftë diçka. Ata më thanë që i kanë njoftë edhe, "Kemi bo diçka", pagesë a kush e di çka, që me u frikësu, unë u frigova se ata qanin kur më përshëndetën. Thashë këta po e dijnë që ka mundësi me u burgosë. Mirëpo, ata me mu ishin si njëri prej familjarëve të tyre.

Kur dolëm, e kalum atë zonën neutrale. Aty po thotë, "A ta thirim mamin tond edhe lajmëroje që ne kalum prej Kosovës?" Thashë, "Pse e kemi kalu?" Tha, "Jo", thashë, "tash je e sigurt mos u frikëso". Edhe po e thirri mamin po i tregoj, "Kështu, kshtu, e kemi kalu". Ajo ma nana me urimet e veta. Mirëpo, pjesa maqedone nuk më lejonte tash me hy në atë anë. Po thashë, "Unë jom banore, kam lindë në Maqedoni, unë i kam prindët atje". Tash ajo pjesa mu më shpëtoi që hyra pastaj në Maqedoni. E për Shqipëri nuk ka qenë e ndalume nga Maqedonia.

**Anita Susuri:** E në Shqipëri...

**Shahadije Neziri Lohaj:** Ka qenë mjaft rrezik a.

**Anita Susuri:** Te naj i afërm?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po, atje më ka prit kjo Zymrija që isha, që ishte e kërkuar me mu, e ndjekur me mu. Ajo kishte shku ma herët atje, ka ardhë më ka marrë kemi hypë në autobus dhe jemi shku në Tiranë. Ajo aty e ka pasë banesën e vet dhe disa familjarë tjerë nga Gjilani kanë qenë që i njifshim. Shkum te ta, kemi qëndru aty. Pastaj kam marrë një apartament, aty kam qëndru. Kur u bo shumë nxehtë shkova në Durrës afër bregdetit aty. Edhe aty e more një apartament. Me të thonë, aty, pjesa ma e vështirë e imja ka qenë kur kanë ardhë të ikurit nga lufta. Ka ndodhë që edhe në banesën ku unë banoja nuk kanë pasë njerëzit mundësi me u shtri po i kam ulë kështu. I merrja rrugës që i takoja, s'kishin ku me u vendosë, i shtija, laheshin, ju jepsha me hongër edhe i çoja te pjesa ku ishin kampet atje.

Aty kom pa histori të ndryshme. Aq shumë histori sa pata marrë aq shumë shënime diku 300 faqe. Mirëpo, këtu ia dhashë dikujna me lexu edhe ma kurrë nuk m'u ka kthy material, që mu edhe ai material më dhimët se ndoshta ka qenë histori që shumë pak ke mujtë me gjetë në atë kohë, që kisha pa. Për shembull, nana që ju kish vdekë foshnja, kisha pa grunë që kish mbetë midis Durrësit dhe i mshonte kokës se i kishte vdekë burri në spital dhe s'dinte ku ka vendin. Kom pa të burgosurit që i prunën nga Smrekonica, që i prunën aty vetëm asht e lëkurë. Kom pa shumëçka, femra të dhunuara, gjithçka që kisha bisedu me plot aty.

**Anita Susuri:** E bashkëshorti juj a ka qenë në Kosovë? A keni pasë kontakt?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Bashkëshorti im ka qenë në Turqi, pastaj osht' ardhë, nuk ka qenë aty. Po, po, kom pasë kontakt.

**Anita Susuri:** E në Turqi që thatë keni udhëtu, a ka qenë...

**Shahadije Neziri Lohaj:** Bashkëshorti im ka qenë atje dhe e kam kunatin tim e kam. Kemi familjarë. Po, po familjarë.

**Anita Susuri:** E familja, nana kështu e prindët?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po gjatë luftës prej nga Maqedonia, sepse unë u vendosa te tezja në Maqedoni, kontaktoja vazhdimisht erdhi edhe nëna. Edhe në Shqipëri erdhi nëna, babai, erdhën më panë atje, vëllai. Kontaktoja me telefon vazhdimisht. Ajo pjesa më e vështirë ishte që kur ikën nga Kosova edhe ata se nuk e dija ku janë, se edhe ata derisa u vendosën diku. Pastaj na lajmërunë se në cilën pjesë janë aty. Ajo ishte ajo pjesë që mu më brengoste shumë. Pastaj, gjyshi gjatë luftës më vdiq

me një fshat dhe nuk e besoja që ai ka vdekë nga vdekja natyrale, kom mendu që mos e kanë masakru e tjerë. Se ne dëgjonim gjithçka atje, nuk ishte e lehtë ajo që e dëgjonim për popullin se çka po ndodhte ktu.

**Anita Susuri:** E kur jeni kthi në Kosovë?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Në momentin që u tërhoq ushtria serbe, unë atë ditë jom kthi në Kosovë. Domethonë, jom kthi nga atje dhe derisa kam arritë. Kam arritë në Ferizaj, ia kom lanë nanës fëmitë se nanat janë zakonisht për qita. I kom hi Kosovës e kom shiku se si osh' shkrumu, sidomos Drenicën.

**Anita Susuri:** Çka keni pa?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Çka kom pa? I kom pa të gjitha ato shtëpi të rrënuara, të gjitha të rrënuara që i kom pa. Kto nuk ka qenë e lehtë, kur e kom pa Kosovën në atë gjendje. Mirëpo, kur e mendoje që ne u çlirim nga pushtuesi serb, prapë kto rregullohen gjanat. Kjo na, domethonë, na ngushëllonte.

**Anita Susuri:** E a keni pasë dame materiale ju? Shpija juj?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po, shpija ime që e kam pasë kanë marrë gjana, të gjitha. Nuk kam gjetë asgja vetëm muret i kam gjetë. Fati që nuk e kishin djegë. Kështu nuk kam gjetë asgja në shtëpi. Me atë më kanë shku edhe fotot e mija, më kanë shku materialet e mija, çka kom pasë të gjitha janë zhdukë. Kushedi kush i ka marrë. Prej familjarëve kemi edhe dëshmorë që kanë ra, e kemi djalin e hallës time që kemi qenë moshatar me ta, Ibrahim Shabani. Ka qenë ni mik që unë e kam pasë ni shoqëri shumë të mirë me Astrit Bytyçi, i cili ka ra heroikisht në kufi. Guresli, Bajrami, të gjithë kta kanë qenë të njofshëm që kemi pasë shoqni me ta. Kemi miq tanë, shokë tanë që kanë ra në altar in e lirisë.

**Anita Susuri:** Qysh ka ndodhë pastaj rikuperimi, fillimi i jetës së re në Kosovë?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Po. Po thashë ajo që ne u çlirim na mbante dhe mendonim që së shpejti do ta ndërtojmë shtetin tonë, do ta krijojmë ato të mirat që duhet t'i jetoj populli jonë, fëmijët tanë, vëllezërit, motrat. Se nuk ishte, nuk ishte edhe aq e thjeshtë kjo punë. Me vite, me shekuj nuk e ke pasë lirinë edhe ti je ajo pjesa që ti e përjetove, sepse njerëzit me shekuj kanë luftu për çlirimin nga Serbia apo nga Turqia mirëpo nuk e kanë pa lirinë. Ne jemi me fat, jemi ajo gjenerata që luftum e veprum, e punum e patëm fatin ta shohim lirinë. Mirëpo, ndoshta nuk jemi të kënaqur me ato krejt veprimet që kanë ndodhë mrena Kosovës. Kemi pritë ma shumë, kemi pritë ma asi, pak jemi të zhgënjyer. Mirëpo jemi të lirë, nuk e kemi Serbinë ktu.

**Anita Susuri:** Ju pastaj ndoshta edhe keni fillu me punën? Ju, bashkëshorti?



**Shahadije Neziri Lohaj:** Po kemi fillu. Pastaj e përfundova ata që më mbetën disa prej provimeve i përfundova, fillova menjëherë me punu në shkollë fillore. Pastaj, më lindi edhe vajza tjetër që them e kam vajzën e lirisë (qeshë). Kom punuar, që nga ajo kohë punoj dhe veproj në shkollën [fillore] “Gjon Serreçi”. Gjenerata të tëra kanë dalë nga ne ktu. Kam punu edhe në shkollën e mesme të mjekësisë, jam marrë me shkrime, jam marrë me aktivitete. Kur ka pasë nevojë, kom vazhdu prapë.

**Anita Susuri:** Zonja Shahadije, nëse doni edhe diçka me shtu për fund, nëse kemi harru diçka me ju pytë?

**Shahadije Neziri Lohaj:** Jo, ndoshta ka shumë shumë, njeriu me ni intervistë nuk mundet m’i përfshi të gjitha ato që i kemi përjetu para luftës e pas luftës e gjatë luftës. Mirëpo, mendoj që disa nga ato gjëra i kam thanë që duhet me i ditë popullata. Shpresoj që rinia jonë ta jetoj jetën, atë që e kemi pasë ne ideal, të jetojmë të lirë e të lumtur e ta krijojnë shtetin. Ta ndërtojnë shtetin ashtu si duhet me i pasë hije ni shteti të mbarë e të mirë.

**Anita Susuri:** Faleminderit shumë.

**Shahadije Neziri Lohaj:** Faleminderit edhe prej juve.